"BOTEK" Sh. P. K. Prishtinë

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 112 / 17
Datë/Datum. 14.04.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

Nr. i AP: ____ **206 14 072 111**_____
(shëno numrin e Aktivitetit të Prokurimit)

ORGANIT SHQYRTUES TË PROKURIMIT

Kundër vendimit të autoritetit kontraktues për eliminimin e kompanisë tonë lidhur me tenderin:

„FURNIZIM ME SOFTVER PËR TESTIM ELEKTRONIK TË KANDIDATËVE PËR PATENTË SHOFER (e-testimi)

(shëno titullin e kontratës si në paragrafin II..1 të Dosjes së Tenderit)

të iniciuar nga

_**Ministria e Infrastruktures**_____

(shëno emrin e Autoritetit Kontraktues)

në afatin ligjor parashtroj këtë:

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit

"BOTEK" sh. p. k.

(shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Agim Ramadani Akt .1. objekt c

(Adresa)

10000

_____*Prishtinë*_____

(Vendi)

(Kodi Postal)

038/245-830

038/245-625

(Numri i telefonit)

(Numri i faksit)

____*Lurian Kasumaj*_____

(emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

info@bo-tek.com

(adresa elektronike)

____*14.04.2017*_____

(data e parashtrimit të ankesës)

(nënshkrimi dhe vula)

IT · Communication · Energy 2002 Prishtinë, Republika e Kosovës 2015

***Ankues mund të jetë pala e interesuar (operatori ekonomik apo grupi i operatorëve ekonomik pjesëmarrës në aktivitetin e prokurimit).*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____

(emri i avokatit)

_____

(adresa e plotë)

_____ _____

(numri i telefonit) *(numri i faksit)*

_____

(adresa elektronike)

_____ _____

(data e parashtrimit të ankesës) *(nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Një përshkrim i shkurtër lidhur me datën dhe emrin e gazetës (ve) ditore në të cilën (at) është publikuar " Njoftimi për Kontratë" si dhe "Njoftimi për dhënie të Kontratës", afati i fundit për dorëzimin e tenderit, data dhe ora e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Data e njoftimit për kontrate: 20.01.2016 Data e dorëzimit të tenderit: 03.10.2016 Data e njoftimit për tenderuesin e eliminuar: 06.12.2016 Kriteri për dhënie te kontratës: Tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po [X] **Jo** [ ]

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ? A keni bërë ndonjë reagim me shkrim dhe/ose kërkuar sqarime shtesë nga AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj, si dhe a u është përgjigjur me shkrim AK në lidhje me këtë? Nëse po, ofroni shkurtimisht detaje mbi këtë fakt:

Po [X] **Jo** [ ]

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë e gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës:

Është shkelur LPP-së: Autoriteti Kontraktues gjate procedurës së prokurimit ka shkelur Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

*** Sipas nenit 113 të LPP-së, OSHP-ja do të konfiskoj Sigurimin e Ankesës tuaj, nëse Paneli Shqyrtues konstaton se të gjitha apo cilado nga pretendimet e bëra në ankesë kanë qenë të rrejshme apo mashtruese.*

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Duke filluar nga 20 Janari i vitit 2016 kur edhe është shpallur si tender i hapur ne mënyrë kronologjike po i përshkruajmë disa nga momente me vendimtare të këtij procesi të cilat kanë dal të jene ne vazhdimësi veprime të kundërligjshme nga ana e AK (Ministrisë së Infrastrukturës).

1. Në ekspertizën e parë (pas ankesës sonë në OSHP) ishin konstatua shkelje të LPP dhe rrjedhimisht OSHP-ja kishte aprovuara ankesën tonë si të bazuar (shih **Vendimin nr. 79/16 të datës, 11. 05.2016 (PROVA 1.)** ku janë evidentuar shkelje të neneve të LPP nga ana e AK - MI, duke e detyruar që AK të ndërroj termat e Referencës (specifikimet e njëanshme teknike dhe rrjedhimisht zgjatjen e afatit për dorëzimin e ofertave.

2. Në vazhdim të kësaj procedure të prokurimit ne si OE kemi qenë të detyruara të shtrojmë ankesën e 2-të pranë OSHP-së dhe mbi këtë ankesë ishte nxjerrë edhe Ekspertiza e dytë e cila kishte konstatua sërish shkelje të LPP nga ana e AK / MI dhe rrjedhimisht OSHP-ja kishte aprovuara ankesën tonë si të bazuara (shih **Vendimin nr. 242/16 të dt. 07. 09.2016** (POVA 2.), ku janë evidentuar sërish shkelje të neneve të LPP nga ana e AK / MI, duke e detyruar që AK të ndërroj termat e Referencës (specifikimet e njëanshme teknike dhe rrjedhimisht zgjatjen e afatit për dorëzimin e ofertave.

3. Me 3 Tetor, është bere dorëzimi i ofertave dhe bashkangjitur është procesverbali i hapjes se tenderit (PROVA 3). Pas procedurës se vlerësimit AK përmes emailit të datës 06.12.2016 na dërgon "*Letrën Standarde për tenderuesin e Eliminuar*" me shpjegimin se *"kompania jonë nuk ka dorëzuar listën e eksperteve siç është kërkuar ne FTD pika 9.1." (PROVA 4)*

4. Pas pranimit të këtij njoftimi ne përmes e-mailit menjëherë e **kemi kundërshtuar konstatim e dhënë nga ana e AK si te pabazuar,** pasi që oferta jone ka qenë e bazuar në LPP si dhe në Fletën e Dosjes së Tenderit (FDT), **ku ne kishim dorëzuara një (1) Origjinal të bashkuar në një zarf të vetëm, por për shkak të volumit detyrimisht i ndarë në dy folldera (Pjesa 1 dhe Pjesa 2.) si dhe 2 Kopje të ndara në zarfe të veçante ashtu sikurse e kërkon LPP në fuqi**. Te gjitha këto Dokumente ishin evidentuar të jene plotësisht konform LPP-së ne Procesverbalin e Hapjes pra dhe rrjedhimisht nuk kishte asnjë vërejtje ne këtë procesverbal.

5. Pas kërkesës sonë për qasje ne dokumentet zyrtare, me datë **07.12.2016** ne prezencën z. Emerllahu (zyrtarë i prokurimit pranë MI), z. Besim Tahiri (Drejtorit të Prokurimit) si dhe 3 personave nga Kompania BOTEK (Hilmi Asllani, Mentor Hakaj dhe Lurian Kasumaj) ne kemi kërkuar të na prezantohen dosja e Dokumentet e kompanisë sonë (Origjinal) si dhe kopjet e dorëzuara nga dhe ne. Me kërkese e drejtorit të Prokurimit drejtuar zyrtarëve të tjerë ne prokurim, janë sjellje të gjitha dokumenteve nga Arkiva në Zyrën e prokurimit ku përveç Follderave Origjinal "Pjesa 1" u sollën edhe 3 Folldera të tjerë të Dosjes së dorëzuara nga ne; Pjesa 1 dhe PJESA 2 (Origjinalit e të ofertës së kompanisë sonë) e pahapur si dhe 2 X KOPJET e pahapura **(PROVA 5. "Fotografia e Dosjeve të dorëzuara dhe gjetura ne Prokurim").**

6. Me këtë rast me propozimin e vet Drejtorit të Prokurimit u hartua një procesverbal (**PROVA 6. "Procesverbali i takimit"**), të nënshkruar nga të gjithë personat prezent, ku u konstatua ekzistimi i Follderit me mbishkrim **"PJESA 2"** e Ofertës së konsorciumit BOTEK / DataProgNet në të cilin gjenden Lista e stafit , CV, Diplomat dhe Certifikimet e tyre dhe i cili gabimisht nuk i ishte dorëzuar komisionit vlerësues.

Prandaj, kërkesa e jonë ne Ankesën pranë OSHP-së ka qenë që Lënda e kësaj Procedurë të Prokurimit ta kthehet në Ri-vlerësim, duke obliguara AK që gjatë procedurës së Ri-vlerësimit të merret parasysh Fakti i pamohueshëm tani më për ekzistimit listës se stafit , CV, Diplomat dhe Certifikimet e personelit të planifikuara për këtë projekt, me çka Oferta jonë si në aspektin Administrativ po ashtu edhe Teknik i plotëson të gjitha kërkesat në DT duke qenë njëkohësisht edhe oferta më e favorshme ekonomikisht.

Mbi këtë ankese me datë: 06.01.2017 ne kemi pranuar **Ekspertizën e 3-të (tretë)** në lidhje me këtë lëndë. Ne këtë ekspertizë në mënyrë të qartë Eksperti Shqyrtues i konstaton shkeljet e bërë nga ana e AK dhe pa asnjë vërejtje për ne si OE, propozon paneli shqyrtues i OSHP-së ta **aprovoj** ankesën tone si të bazuar dhe lënda të kthehet në **Ri-vlerësim.**

Vlen te theksohet se, sipas Procedurave dhe Praktikave të OSHP-së në rast se pala Ankuese si dhe AK pajtohen ose nuk kthejnë përgjigje përmes e-mailit për ta kundërshtuar mendimin e Ekspertit brenda afatit ligjor prej 4 ditëve citat nga OSHP: *("Te nderuar, në attach gjeni mendimin e ekspertit nr.466/16, ju lutemi na e konfirmoni pranimin e shkresës dhe ne baze te nenit 115.1 te LPP-se 04/L-042, ne afat prej katër ditësh, na e ktheni një përgjigje lidhur me pajtimin ose jo me mendimin e ekspertit ne mënyrë qe pas përgjigjeve tuaja paneli te caktoje dhe te mbaje seancën për vendimin përfundimtare te kësaj lende.")*, paneli Shqyrtues i OSHP-së nuk ka asnjë arsye të organizoj mbajtjen e një seance dëgjimore shtesë për një lëndë dhe me automatizëm merr një Vendimin sipas Propozimit të Ekspertizës.

Ndërsa, për sa i përket pjesës në *"Udhëzuesin Operativ për Prokurim Publikë" (shkurt UOPP)*, ne dëshirojmë të qartësojmë se AK pikërisht duke qene i obliguar te punoj ne baze te këtij udhëzimi i cili atyre iu shërben si dokument pune të përditshme, në "**Procesverbalin e Hapjes së Tenderit " të mbajtur me 03.10.2016** , (**PROVA 3.**), nuk ishte shënuar asnjë vërejtje në lidhje me cilindo aspekt formal së Ofertës së dorëzuar nge ne apo edhe OE të tjerë pjesëmarrës në këtë procedurë të prokurimit.
Po të ekzistonte si kërkesë në FDT (**PROVA 12**)dhe një OE mund ta ketë harruar ta përmbushë ketë aspekt formal, sipas vetë LPP dhe kësaj rregulloreje ky aspekt formal mund të përkufizohet një pikë dhe çështje absolutisht minore, e parëndësishme e cila në çdo rrethane mund të përmirësohet dhe sqarohet nga AK pa ndryshuar asnjë aspekt material dhe të ofertës së OE komform nenit 59 paragrafi 4 i LPP-së.
Derisa AK nuk e ka kërkuar numërimin e faqeve, AK nuk ka pas asnjë vërejtje ne lidhje me ketë aspekt formal të ofertës sonë as gjate procedurës se hapjes apo vlerësimit. Rrjedhimisht gjate gjithë kësaj procedure asnjëherë nuk ka pas asnjë ankesë në lidhje me këto aspekt formale dhe ekspertiza nuk ka trajtuar një aspekt të tillë minor dhe formal.
Aspekte të tilla formale dhe minore AK në çdo kohë ka mundësi të përmirësoj, pa ndryshuar asnjë aspekt të teknik / material apo Administrativë të Ofertave dhe veprim ky absolutisht i bazuar ne LPP dhe Udhëzuesi Administrativ Për Prokurim Publik (**PROVA 11**) i cili decidivisht i lejon dhe obligon AK të bëjnë përmirësime aritmetike deri në përqindje të caktuar apo të sqaroj çfarëdo paqartësie formale dhe minore tjetër me OE gjithmonë duke mos e lejuar të preket asnjë aspekt teknik, material apo futjen e ndonjë dokumenti shtesë në dosje e tenderit (**PROVA 8., neni 59 e LPP paragrafi 4 qartësojnë ketë aspekt**).

Për më tepër, Paneli shqyrtues i kësaj lënde bën faktet e pamohueshme të cilat janë të evidentuara edhe në ekspertizën e kësaj lënde ku qartësisht konstatohet se konsorciumi i OE PBC shpk & GIS Data nga Maqedonia nuk janë të përgjegjshëm në aspektin administrativ (PROVA 9)., **"Ekspertiza e lëndës faqe 31").**

Pra paneli shqyrtues i OSHP-se ne kete vendim vet konstaton faktet e pamohueshme se kompania e propozuar për kontrate është e pa-përgjegjshme CITAT: *"kompania e propozuar për kontrate ne dokumente e dosjes se tenderit se deklaratat e afatit te liferimit, mirëmbajtjes dhe garancionit si dhe deklarata për specifikime teknike përmbajnë vulën e **PBC shpk** ndërsa ne përmbajtje është përshkuar ne cilësi te kompanisë tjetër PBC KOSOVA.".*
Ky konsorzium i perbërë nga PBC shpk dhe GDI NUK posedon asnjë AUTORIZIM (MAF) valid ne ketë procedurë të prokurimit pasi që Autorizimet e ne Oferten e tyre janë të lëshuara në emër të një OE tjetër me emër PBC Kosova dhe Numër Biznesi tjetër të biznesit.
Për ta kamufluar këtë mospërputhje të qartë Administrative ky grup i OE (PBC shpk & GDI) qëllimisht e kanë emërtuar konsociumin si "PBC Kosova" me emër te njejte sikurse OE tjetër qe vepron ne Kosove me emrin PBC Kosova, për te cilin edhe janë lëshuar autorizimet ne fjale.
Për më tepër duhet të qartësojmë faktin se Prodhuesit e ndryshëm si ne ketë rast (HP, VEEAM etj) ne asnjë rast dhe rrethan nuk Lëshojnë Autorizime në emër të ndonjë konzorciumi por vetëm në emër të një kompanie / partneri.

Pra, nëse shikohet edhe ekspertiza atje janë të numëruara një numër i madh i mospërputhjes së dokumenteve të ndryshme administrative të cilat përbëjnë shkelje të LPP-se nga ana e AK dhe rrjedhimisht edhe Panelit Shqyrtues i cili duke dashur të i fsheh të gjitha këto shkelje, në **Vendimin e tyre faqe 8/8** (PROVA 10)provon ti minimizoj dhe kamufloj këto mospërputhjen shkelje Administrative të këtij konzorciumi duke i *"kualifikuara të gjitha këto si devijime minore dhe duke u thirre ne LPP nenit 59. Paragrafi 4."*

Vlerësojmë se ky pershkrim kronologjik shpjegon dhe permbane prova te mjaftueshme per te anulohet njoftimi per dhenie te kontrates i dates 07.04.2017 dhe kjo lende te kthehet ne rivlersim

Telecommunication · Energy · Construction
BETEK sh.p.k.
Prishtinë, Republika e Kosovës 2015

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës:

Nga humbja e kësaj kontrate kompania jone humb fitime financiare, shkelet LPP

9. Propozim

Ofroni, nëse është e mundur propozimin tuaj për hapat e mëtutjeshëm në lidhje me këtë aktivitet të prokurimi:

- Anulimi i dhënies se kontratës dhe kthimi e procedurës ne ri-vlerësim

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Regjistroni secilën dëshmi të cilën do t'i bashkëngjitni ankesës tuaj. Në mënyrë që ankesa juaj të merret në shqyrtim, duhet të ketë të bashkangjitur patjetër ***Publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës*** *me të cilën do të dëshmohet data si dhe emri i gazetës në të cilën është publikuar ky njoftim apo njoftimin e kandidatëve dhe tenderuesve të eliminuar, procesverbalin e hapjes publike të tenderëve, si dhe të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

1. Deklarata mbi faktet dhe argumentet.
2. Hapja e tenderit
3. Njoftimi për tenderuesin e eliminuar
4. FTD
5. Vendimin per shqyrtimin e ankesës - Refuzim,
6. Flete pagesa

*** Sipas nenit 106.2 të LPP-së, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës në fjalë, do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe më pas një kopje të protokolluar nga OSHP-ja do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*